

# MITI LETRAR TE ROMANI *SHKRETËTIRA* I LE CLÉZIO

**Shejnaze AJDINI-MURTEZI**

Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Frënge

shejnaze.ajdini@unite.edu.mk

**Besa SALIU**

besasaliu@hotmail.com

**UDC 821.133.1-31.09**

*Conference paper*

## **Abstract**

Today the term *myth* and *mythology* is quite current and is showing a significant change in the field of academic knowledge. *Mythos* represents the intrigue or development of a factual history, a term that tells stories that concern God or any other deity. Especially in France, myth is a very important issue in the field of literary studies. According to Mircea Eliade: „The myth tells a sacred story, links an event that happened in the initial time, the wonderful start time“. During 1950s, Roland Barthes published a series of semiotic analyzes of modern myths, and summed up their creativity in the book *Mythologies*. To understand literary myth in the novel *Désert*, one should analyze the intersection of the stories that appear in this novel.

The first is the story of Morocco's liberation efforts by the French army, the failure of the holy war against Christians, and the second story is the appearance of new life of Lalla how is born in the desert and its immigration to France to return to end to its place and roots. What intrigues us is the process of forming the desert myth in the creative spirit of Le Clézio and the myth of the novel. The wilderness is a place of loneliness and drought, but at the same time it is also a place where man can defeat his demons only through his spiritual strength.

**Key words:** *Le Clézio, myth, literature, history, universal.*

## **Përmbledhje**

Sot termi *mit* dhe *mitologji* është mjaft aktual dhe po tregon një ndryshim të theksuar në fushën e njohurive akademike. *Mythos* paraqet intrigë ose zhvillim të një historie faktike, term

i cili tregon histori që ka të bëjë me Zotin ose me çdo hyjni tjetër. Duhet theksuar se sidomos në Francë, miti është çështje shumë e rëndësishme në fushën e studimeve letrare.

Sipas Mircea Eliade: „Miti tregon një histori të shenjtë, lidh një ngjarje që ka ndodhur në kohën fillestare, kohën e mrekullueshme të fillimeve“. Gjatë vitit 1950, Roland Barthes publikoi një seri të analizave semiotike të miteve moderne, dhe krijimtarinë e tyre e përmbloodhi në librin *Mitologjitë*. Për ta kuptuar mitin letrar në romanin *Shkretëtira* duhet analizuar kryqëzimin e historive që paraqiten në këtë roman.

E para është historia e përpjekjeve të çlirimit të Marokut nga Ushtria franceze, dështimi i luftës së shenjtë kundër krishterëve, dhe historia e dytë është paraqitja e jetës së re të Lalla-s, e lindur në shkretëtirë dhe imigracionin e saj në Francë për t'u kthyer më në fund në vendin dhe rrënjët e saja. Ajo çka na intrigon është procesi i formimit të mitit të shkretëtirës në shpirtin krijues të Le Clézio-së dhe formën që merr miti në roman. Shkretëtira është vend i vetmisë dhe i thatësisë, por në të njëjtën kohë është edhe vend ku njeriu mund t'i mposhtë demonët e tij vetëm nëpërmjet forcës së tij shpirtërore.

**Fjalët kyçe:** *Le Clézio, mit, letërsi, histori, universale.*

## Hyrje

Nëse problematika e mitit letrar mund të trajtohet nga pikëpamja e mirëfilltë letrare ose nga pikëpamja strikte estetike, kjo mund të shqyrtohet edhe nga perspektiva historike, sociologjike dhe filozofike. Me këtë rast do të dilnin në pah faktorët dhe paradokset me të cilat përballen letrarja dhe jashtëletrarja, e vërteta dhe e pavërteta, realja dhe irealja, racionalja dhe iracionalja. Në Mesjetë miti fiton tjetër status dhe rrjedhimisht ndryshon edhe receptimi i teksteve fikzionale antike. Por edhe tekstet e kësaj periudhe, të Mesjetës, sot kanë tjetër receptim nga ai i dikurshmi. Në punimin tonë miti është përdorur vetëm për të sugjeruar më mirë kufizimin e qasjes tonë që do të mjaftohet në kuadrin e aktivitetit letrar.<sup>1</sup>

## Miti letrar si koncept bashkëkohor

Legjenda, sipas Claude Millet hyn, bashkë me mitin, në dispozitivin e legjendaren (La légende entre, avec le mythe, dans le dispositif du légendaire).<sup>2</sup> Zërat e shkretëtirës përbëjnë legjendën e shkretëtirës. Pikënisja e shkretëtirës është një epizodë autentike e historisë: ngjitja kah Veriu e Mauritanëve, e udhëhequr nga Ma el Aïnine, kur Franca hyn në Maroko, prej vitit

---

<sup>1</sup> Mircea Eliade, *Mythes, rêves, mystères*, Gallimard, Paris, 1996, fq. 64.

<sup>2</sup> Claude Millet, *Le Légendaire au XIX siècle, poésie, mythe et vérité*, Paris, PUF, 1997, fq. 5.

1909 deri më 1912, data e vendosjes së protektoratit francez në Maroko. Datat dhe toponimet ndërhyjnë si dëshmi për autenticitetin e ngjarjeve të rrëfyera.

Struktura e romanit *Shkretëtira* është ndërtuar mbi dy akse narrative paralele, të cilat përbëjnë dy universe krejt të pavarura, të lidhura nga një nyjetim i përbashkët - shkretëtira. Aksi i parë narrativ rrëfen ngjarje reale dhe kolektive të fiseve nomade të Saharasë. Narracioni fokalizohet në marshimin e nomadëve nëpër shkretëtirë pas humbjes së tyre nga ushtria franceze me rastin e kolonizimit të Marokut nga Franca, ndërmjet viteve 1909 dhe 1912.

Aksi i dytë narrativ fokalizohet në një ngjarje fiktive dhe individuale të një vajze të lindur në shkretëtirë, e cila „e zbulon” qytetërimin perëndimor në një periudhë që mund të jetë analoge me atë kur shkruhet edhe libri. Ngjarjet ndodhin në vitet tetëdhjetë të shekullit XX.<sup>3</sup> Lalla, pasardhëse e „njerëzve të kaltër (Les hommes bleus)“, pas vdekjes së nënës së saj, do të shkojë të jetojë te tezja e saj, e cila banonte në një lagje të varfër të Marseille-it. Edhe pse më vonë bëhet një modele e njohur revistash, ajo nuk mund t'i ikë tërheqjes së saj ndaj natyrës, popullit të saj, dashurisë së për Hartani-n, bariun e ri.

Le Clézio i përdori fuqishëm burimet e reales në roman, si marshimi dhe humbja e „njerëzve të kaltër (Les hommes bleus)“ që paraqet mjerimin e njeriut të sotëm, në këtë rast, njërën ndër episodet më të errëta të kolonializmit francez. Po aq shkathtësisht ai ndërthuri përbrenda saj burimet e fiktives, si rrëfimin për Lalla-në që nxjerr në pah avanturën njerëzore të njeriut të sotëm.

Duke e vënë pikëshikimin në një vajze nomade, një emigrante, Le Clézio i ofron lexuesit mundësinë të krijojë një pikëshikim tjetër mbi qeniet dhe situatat që ai i ka krijuar përgjithësisht nëpërmjet filtrit të diskursit social dhe politik. Por, origjinaliteti i Le Clézio-s, i cili ishte i bindur se arti është i mundshëm vetëm si emocion, konsiston në atë se duke e shkruar *Shkretëtirën* ai krijoi një mit të vërtetë, personal dhe universal, për të paraqitur vizionin e tij për botën.

Ai e dinte se miti është fjalë që ka ndikim të atypëratyshëm në ndjeshmërinë dhe imagjinatën e lexuesit. Kundërvënia ndërmjet urbanes dhe shkretëtirës shpreh një filozofi jetësore, e cila ka për qëllim të fundëm kërkimin e një urtësie dhe harmonie të lidhur me ëndrrën për kohën dhe hapësirën origjinare. *Shkretëtira*, në të vërtetë, na e vë përpara imazhin e përmbysur të kësaj ëndrre.<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup> Avdi Visoka, *Shkrim dhe recepitim*, Faik Konica, Prishtinë, 2016, fq. 135.

<sup>4</sup> Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AIKD, Prishtinë, 2012, fq. 104.

Sa i përket shkretëtirave, Le Clézio shpreh: „J’aime ce qui montre la présence d’un cataclysme ancien, les traces d’une vengeance ancienne [...] qui montre que la Terre a été la Lune ou qu’elle va l’être quelque chose qui montre que la vie n’est pas éternelle et que la Terre peut devenir squelette“.<sup>5</sup> Lidhjet në mes të zjarrit dhe shkretëtirës janë të dyfishta: zjarri, element destruktiv dhe krijues mund të jetë me origjinë nga një hapësirë e shkretëtirës: ai shfaqet nëpërmjet nxehtësisë së zjarrtë dhe dritës djegëse.

*Shkretëtira* me hapësirën e paprekur, dritën, qetësinë, del si simbol i krejt anës njerëzore që gjakon përbrenda njeriut, ndërsa urbanja inkarnon çnjerëzoren dhe kotësinë e marrëdhënieve njerëzore. Dramat e Nurit dhe Lalla-së u kundërvihen brutalitetit dhe cinizmit të qytetërimeve perëndimore, vlerave materiale dhe ambicieve të sëmura për dominim dhe pasurim. Ato fuqishëm na kujtojnë ngulmimin shpirtëror që i vë në lëvizje forcat e brendshme të njeriut për të ruajtur dinjitetin dhe lirinë kundër çfarëdo forme të skllavërisë.

Indikatorët e saktë hapësinorë dhe kohorë që shtrihen përgjatë tërë aksit të parë të rrëfimit, por edhe titujt dhe elementet e tjera paratekstuale që e përshkojnë aksin e dytë narrativ *Shkretëtirës*, i japin një përmasë të romanit historik.<sup>6</sup> *Shkretëtira* përafrohet me romanin historik në kuptimin e parashtrimit të argumenteve historike. „Franca e kishte kolonizuar Algjerinë që në gjysmën e parë të shekullit XIX, por Maroku ia doli ta ruajë pavarësinë e tij deri në fillim të shekullit XX.

Le Clézio, jo vetëm që trajton argumentet historike, por depërton deri në shkaqet që sollën këtë kolonizim. Teksti i Le Clézio-s ndjek besnikërisht kronologjinë e këtyre ngjarjeve nëpërmjet indikatorëve të saktë kohorë dhe hapësinorë. Aty përshkruhen në detaje betejat, datat dhe vendet“.<sup>7</sup> Ndonëse përshkruhet në episode të shkurtra dhe të errëta, rrëfimi i betejave jep fuqishëm dhunën e një lufte të pabarabartë. Le Clézio i jep vend qendror udhëheqësit historik të kryengritësve kundër pushtuesve francezë. Ndoshta ai është personazhi më karizmatik, por edhe më tragjik i romanit.

Le Clézio, si fëmijë shtatëvjeçar, e kishte vizituar Afrikën. Aty kishte bërë dy njohje që do të linin gjurmë të thella në kujtesën e tij. Kishte njohur babanë e vet dhe Afrikën, në të cilën babai shërbente si mjek në ushtrinë angleze. Disa vjet më vonë e vizitoi Marokun ku e

---

<sup>5</sup> Pierre Lhoste, *Conversation avec J. M. G. Le Clézio*, Paris, Mercure de France, 1971, fq. 83.

<sup>6</sup> Avdi Visoka, *Shkrim dhe receptim*, Faik Konica, Prishtinë, 2016, fq. 203.

<sup>7</sup> J. M. G. Le Clézio, *Shkretëtira*, Toena, Tiranë, 2012, fq. 69.

gjejmë një variant primitiv të *Shkretëtirës*. Por, Le Clézio nuk e kishte vizituar Saharanë marokene para se ta shkruante *Shkretëtirën*.

Përpara se ta prekte shkretëtirën, ajo ishte një vend teorik dhe abstrakt. Para së gjithash, ishte një hapësirë me konotacione të fuqishme simbolike. Ai e përdorë termin shkretëtirë në tërë shtrirjen e tij semantike. Shkretëtira është vend i heshtjes, i varfërisë por njëkohësisht edhe vend i autenticitetit dhe i pranisë së sakrales. Në romanin e Le Clézio-s, shkretëtira përshkruhet si vend mitik, sepse ajo situohet jashtë rrjedhës së kohës lineare.

Ligjet e zhdukjes së pandërprerë nuk i kanë mundësuar historisë njerëzore të lënë gjurmë, „ai ishte vend jashtë kohës, jashtë historisë së njerëzve, ndoshta, vend ku më asgjë nuk mund të lindte ose të vdiste“.<sup>8</sup> *Shkretëtira* e Le Clézio-s është më shumë mitike dhe më pak gjeografike. Një përshkrim i tillë simbolik i hapësirës sakrale na kujton Mircea Eliade i cili shprehet: „Në hapësirën sakrale nuk duhet të ekzistojë ndërprerje ndërmjet këtyre tri momenteve të të njëjtit mister, që janë gjenerimi, vdekja dhe rigjenerimi“.<sup>9</sup>

Për këtë arsye, në shkretëtirë, të vdekurit u shfaqen të gjallëve përderisa në tokën profane vdekja është ndarje e pakthyeshme. Personazhet të cilët e popullojnë shkretëtirën e humbin gjithë realitetin për t'u bërë si vegime. Ata janë të cituar me *ata (ils)* të paidentifikuar që asocion me një të pakryer: „Ils marchaient sans bruit dans le sable, lentement, sans regarder où ils allaient (Ata ecnin pa bërë zë nëpër rrëzë, ngadalë, pa shikuar se ku shkonin)“.<sup>10</sup>

Sa i përket personazhit të Lalla-s, ajo ndërtohet në mënyrë metaforike në anonimat e qyteteve të mëdha, deri edhe në humbjen e gjithë realitetit: „Pour les autres c'est comme si elle n'existait pas (Për të tjerët ishte sikur ajo të mos ekzistonte)“.<sup>11</sup> Në imazhin e gjurmëve të hapave mbi rrëzë, këto gjurmë metaforike si janë kujtimet e pavetëdijshme e fusin Lalla-n në vazhdimësi të nomadëve dhe në legjendën e shkretëtirës së ruajtur në memorien e kolektive. Kujtesa mbijeton me anë të transmetimit gojor dhe të pandërprerë të të ngjarjeve të njëjta, nga gjenerata në gjeneratë.

Forma gojore është ende një pikë e përbashkët në mes të legjendës dhe epopesë. Claude Millet<sup>12</sup> shprehet se zëri qarkullon nga rrëfyesi te dëgjuesi ashtu siç vendoset qarkullimi në mes të roleve të secilit prej tyre: i njëjti personazh mund të jetë njëkohësisht rrëfyesi, objekt i rrëfimit i krijuar nga në tjetër dëgjues në një tjetër kontekst.

---

<sup>8</sup> J. M. G. Le Clézio, *Shkretëtira*, Toena, Tiranë, 2012, fq. 11.

<sup>9</sup> Mircea Eliade, *Mythes, rêves, mystères*, Gallimard, Paris, 1996, fq. 277.

<sup>10</sup> J. M. G. Le Clézio, *Shkretëtira*, Toena, Tiranë, 2012, fq. 7.

<sup>11</sup> J. M. G. Le Clézio, *Shkretëtira*, Toena, Tiranë, 2012, fq. 293.

<sup>12</sup> Claude Millet, *Le Légendaire au XIX siècle, poésie, mythe et vérité*, Paris, PUF, 1997, fq. 99.

## **Përfundimi**

Në këtë punim u analizua miti letrar të romani *Shkretëtira* e Le Clézio-s që shenjon dy faqe të ndryshme të të njëjtës pasqyrë e cila reflekton shqetësimin universal për njeriun dhe vlerat njerëzore. Kjo disonancë letrare e bën Le Clézio-n shkrimtar edhe më kozmopolitan. Le Clézio, i njohur botërisht për vokacionin e vet kontestues e solidar që lidhet me kozmopolitizmin e tij origjinar, e bën të vështirë përcaktimin nacional të tij.

Nënshkrues i manifestit „Për letërsinë e botës“, madje nuk pranoi të identifikohet as si shkrimtar francez me rastin e pranimit të çmimit Nobel, më shumë preferoi të identifikohet si shkrimtar i letërsisë në gjuhën frënge e cila nuk i ka rrënjët në konceptin e kombit. Le Clézio është „shkrimtar i thyerjes, i avanturës poetike dhe ekstazës sensuale, eksplorues i një humaniteti përtej dhe mbi qytetërimin mbizotërues“, nënvizonte Akademia suedeze në komunikatën e shpalljes së tij fitues të çmimit Nobel.

## **Bibliografia**

ELIADE, Mircea (1996). *Mythes, rêves, mystères*, Paris: Gallimard.

LE CLÉZIO, J. M. G. (1980). *Désert*, Paris: Gallimard.

LE CLÉZIO, J. M. G. (2012). *Shkretëtira*, Tiranë: Toena.

LHOSTE, Pierre (1971). *Conversation avec J. M. G. Le Clézio*, Paris: Mercure de France.

MILLET, Claude (1997). *Le Légendaire au XIX siècle, poésie, mythe et vérité*, Paris: PUF.

VISOKA, Avdi (2011). *Koha e shkrimit*, Prishtinë: 99-AIKD.

VISOKA, Avdi (2016). *Shkrim dhe receptim*, Prishtinë: Faik Konica.